

UDHËZIM
Nr. 629, datë 27.8.2018

MBI PËRCAKTIMIN E MASËS PËR PËRFITIMIN E PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 42/3, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, pikave 2, 3, 16 dhe 17, të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Paga bazë për shkak të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 2 të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, është 10,575 (dhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 6.345 (gjashtë mijë e treqind e dyzetë e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “b”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 8.460 (tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

4. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “c”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 10.575 (dhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

5. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “ç”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 12,690 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

6. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “d”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 4,759 (katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

7. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “dh”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 6,346 (gjashtë mijë e treqind e dyzetë e gjashtë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

8. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “e”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 7,931 (shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

9. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “ë”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 9,517 (nëntë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

10. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 16, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për shërbimet gjithëpërfshirëse të ndihmësit personal, është 12,690 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

11. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 17, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për shërbimet e herëpashershme të ndihmës personal, është 8,460 (tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I, të vendimit.

12. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2018 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2018, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

13. Udhëzimi nr. 22, datë 7.10.2016, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu